



ENEMO fillon vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës 2010

ENEMO (Rrjeti Evropian i Organizatave për Monitorimin e Zgjedhjeve) po organizon misionin për të vëzhguar zgjedhjet e radhës së Kuvendit të Kosovës 2010. Selia e misionit është në Prishtinë, dhe një ekipë qendrore shtatë anëtarëshe po përgatit terrenin për ardhjen e 12 vëzhguesve afatgjatë dhe rreth 150 vëzhguesve afatshkurtër për ditën e zgjedhjeve.

ENEMO është një grup i 22 organizatave nga shtatëmbëdhjetë vende të ish-Bashkimit Sovjetik dhe të Evropës Qendrore dhe Lindore. Këto organizata jopartiake janë udhëheqës të grupeve të monitorimit të zgjedhjeve vendore në vendet e tyre përkatëse. Në total, organizatat anëtare të ENEMO kanë vëzhguar 200 zgjedhje kombëtare në vendet e tyre dhe më shumë se 100 zgjedhje jashtë vendit dhe kanë trajnuar 200 000 vëzhgues të zgjedhjeve.

Misioni ENEMO drejtohet nga Z. Zlatko Vujovic, President i Bordit të CEMI, Qendra për Monitorim në Mal të Zi.

Si një nga miratuesit, ENEMO zbaton standarde të larta të përcaktuara në "Deklaratën e parimeve për vëzhgimin ndërkombëtar të zgjedhjeve dhe kodin e sjelljes për vëzhguesit ndërkombëtarë". Vëzhguesit e ENEMO veprojnë dhe kryejnë punën e tyre në përputhje me këtë deklaratë. Vëzhguesit afatgjatë dhe afatshkurtër veprojnë në grupe prej dy anëtarësh dhe do të vendosen në rajonet që mbulojnë tërë territorin e Kosovës. Vëzhguesit e ENEMO do të vëzhgojnë dhe do të vlerësojnë, të bazuar në kuadrin ligjor dhe standardet ndërkombëtare, procesin zgjedhor: në punën e administratës zgjedhore, 10 ditët e aktiviteteve të fushatës, votimin, numërimin e votave dhe nxjerrjen e rezultateve, si dhe menaxhimin e procedurave të ankesave dhe parashtesave.

Misioni i vëzhgimit është i mbështetur nga USAID-i përmes Institutit Kombëtar Demokratik për Çështje Ndërkombëtare (NDI), Ambasada e Britanisë së Madhe dhe Ministria e Punëve të Jashtme të Suedisë dhe Ministrisa e Punëve të Jashtme të Norvegjisë.

Per me shume informata

Gazmend Agaj
Press Officer
ENEMO Election Observation Mission – Zyrat qendrore
Andrea Gropa nr.30, 10000 Pristina
Email: gazmend.agaj@enemo.eu
Tel:+386 (0) 49-157-729